

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË TATIMEVE ELBASAN

Raporti përfundimtar i auditimit të ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Elbasan “Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në procesin e realizimit të të ardhurave tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm” për periudhën 2013-2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 60, datë 30.06.2015. Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresat nr. 179/26 dhe nr. 179/25, datë 04.07.2015, për znj. Brisida Shehaj me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve dhe z. Mustafa Halili me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, i janë dërguar “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. REKOMANDIM PËR PËRMIRËSIM LIGJOR:

A.1. Nga auditimi është konstatuar se nga drejtorët e Drejtorisë Rajonale Elbasan, lidhja e marrëveshjeve për shlyerjen e borxhit tatimor me subjektet tatimpagues është bërë jashtë afatit të përcaktuar në udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ku cilësohet:

Pika 77.2 “Kërkesa nga ana e personit të tatueshëm bëhet me shkrim dhe i drejtohet, Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve. Në kërkesë paraqiten të gjithë rrethanat në të cilat ndodhet personi i tatueshëm dhe arsyet pse ai kërkon të lidhë një marrëveshje për të paguar me këste detyrimet e tij tatimore. **Kërkesa duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga data kur njoftimi i vlerësimit konsiderohet të jetë marrë**”.

Pika 77.3.1 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, kur e sheh të argumentuar kërkesën e personit të tatueshëm, **brenda një afati prej 10 ditë pune** nga marrja e kërkesës, mund të pranojë pagesën me këste të detyrimit tatimor duke hartuar në këtë rast një marrëveshje me shkrim e cila nënshkruhet nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve dhe nga personi i tatueshëm”.

Kjo procedurë zgjat 25 ditë, çka do të thotë që subjekti tatimpagues duhet të lidhë marrëveshjen brenda këtij afati.

Nga ana tjetër sipas udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 cilësohet:

Pika 89. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar

89.1 Duke pasur parasysh përmbushjen e dispozitave të pikës 88 më lart (afati ligjor 40 ditë, 10 ditë marrja e njoftimit vlerësimit dhe 30 ditë afati i ankimimit) kur administrata tatimore, arrin në përfundimin se një detyrim tatimor nuk është paguar plotësisht, ajo menjëherë njofton tatimpaguesin për detyrimin e papaguar, nëpërmjet postes rekomande. Njoftimi i tatimpaguesit për të paguar detyrimet tatimore, nxirret brenda 10 ditëve nga ana e administratës tatimore, dhe ky afat fillon të llogaritet nga data kur tatimpaguesi ka pasur detyrimin për ta paguar atë (10+30).

Administrata tatimore duhet ta nxjerre njoftimin e **kërkesës për pagim** brenda tre ditëve pune nga dita e parë e punës **pas përfundimit të afatit ligjor për pagimin e detyrimeve (10+30)**. Njoftimi vendoset në dosjen e tatimpaguesit brenda 5 ditëve nga data e dërgimit të tij me postë rekomande, apo nga data kur njoftimi i është dorëzuar dorazi tatimpaguesit kundrejt konfirmimit të këtij të fundit për marrjen e tij. **Me kalimin e 10 ditëve**

nga data e nisjes me postë të këtij njoftimi ose brenda 3 ditëve nga data e dorëzimit tatimpaguesit të njoftimit, **fillon zbatimi i procedurës për mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore.**

Për sa më sipër, ka një kontradiksion që konsiston:

-Nëse do të plotësohej ky afat, pra lidhja e marrëveshjeve brenda 25 ditëve, në asnjë rast nuk do të linde nevoja për zhblokim llogarish, pasi në asnjë rast për shkak të afateve dhe procedurave nuk lind nevoja e bllokimit të tyre;

-Nga ana tjetër brenda këtij afati (25 ditë për lidhjen e marrëveshjes) ky detyrim ende nuk është kategorizuar si borxh tatimor, pasi subjekti është brenda afatit ligjor prej 40 ditësh nga dalja e njoftim vlerësimit (10 për marrjen e njoftim vlerësimit dhe 30 ditë për ankimim në zbatim të KPA), pra subjektit tatimpagues nuk ka i ka lindur detyrimi ligjor, për lidhje marrëveshje, pasi ende nuk është kategorizuar si subjekt me borxh tatimor.

Për këtë është propozuar që, Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Ministria e Financave, të bëhet një ndryshim në pikën 77.2 të udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, ku pika 77.2:

Është: “Kërkesa nga ana e personit të tatueshëm bëhet me shkrim dhe i drejtohet drejtorit të drejtorisë rajonale të tatimeve. Në kërkesë paraqiten të gjithë rrethanat në të cilat ndodhet personi i tatueshëm dhe arsyet pse ai kërkon të lidhë një marrëveshje për të paguar me këste detyrimet e tij tatimore. **Kërkesa duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga data kur njoftimi i vlerësimit konsiderohet të jetë marrë**”.

Të bëhet: “Kërkesa nga ana e personit të tatueshëm bëhet me shkrim dhe i drejtohet drejtorit të drejtorisë rajonale të tatimeve. Në kërkesë paraqiten të gjithë rrethanat në të cilat ndodhet personi i tatueshëm dhe arsyet pse ai kërkon të lidhë një marrëveshje për të paguar me këste detyrimet e tij tatimore. **Kërkesa duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga data kur kërkesë pagesa konsiderohet të jetë marrë**”.

Trajtuar në faqet 139-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

B. MASA ORGANIZATIVE

B.1. Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit dhe evidencat mbi numrin e tatimpaguesve të regjistruar të rinj, të reregjistruar, të kaluar në regjistrin pasiv, të çregjistruar, të riaktivizuar, si dhe nga mungesa e regjistrit të subjekteve të kaluar në pasiv nga subjekte aktiv, e regjistrit të subjekteve të cilët kanë qenë të pa regjistruar u konstatua se, nuk janë zbatuar kërkesat e pasqyruara në udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, pika 41 “Identifikimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregtare të pa regjistruar”, pika 43 “Ndryshimet në regjistër” dhe pika 44 “Kalimi në regjistrin pasiv”.

Trajtuar më hollësisht në faqet 25-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria e Shërbimit për Tatimpaguesin të marrë masa me qëllim saktësimin e evidencave mbështetëse dhe regjistrin e tatimpaguesve të kaluar në pasiv nga subjekte aktiv, si dhe regjistrin e subjekteve të cilët kanë qenë të pa regjistruar, të regjistruar të rinj, të reregjistruar (*shtesa e pakësime*), të kaluar në regjistrin pasiv, të çregjistruar si dhe të riaktivizuar.

Menjëherë

B.2. Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit në dosjet e tatimpaguesit për dinamikën, lëvizjen dhe dokumentacionin e domosdoshëm për çregjistrim të tatimpaguesit u konstatua se, në kundërshtim me udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, pika 45 “Çregjistrimi tatimor”, pika 45.1 “Çregjistrimi i personave të tatueshëm që kryejnë veprimtari ekonomike e tregtare”, pika 45.3 “Efektet tatimore të çregjistrimit”, mungon

kërkesa në QKR e subjektit për çregjistrim aktiviteti, saktësimi i detyrimeve të likuiduara, verifikimi në terren, ndërkohë që sistemi para çregjistrimit gjeneron detyrime. Mungon pasqyrimi në se subjekti ka dorëzuar bilanc për mbyllje aktiviteti, apo vonesa në plotësimin nga inspektori për çregjistrimin në sistem, në raste të veçanta edhe mbi 2 vite deri 3 vite. *Trajtuar më hollësisht në faqet 25-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria e Shërbimit për Tatimpaguesin në bashkëpunim me Drejtorinë e Vlerësimit të të Ardhurave dhe Kontabilitetit të marrë masa me qëllim kompletimin e dokumentacionit në dosjet e tatimpaguesve, si edhe të bëjë rakordim për saktësimin e detyrimeve dhe çregjistrimin në kohë të tatimpaguesit.

Menjëherë

B.3. Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurat e ndjekura për auditimin e deklarimeve periodike për të vlerësuar veprimtarinë e DRT, mbi llogaritjen dhe pagesën e tatimit në burim të qirasë, u konstatua se në vitin 2013 derdhet në burim, tatim qira nga 346 ambiente, ku operojnë subjektet e regjistruara në DRT Elbasan, të cilët përbëjnë rreth 4 % e totalit të subjekteve të regjistruar. Në vitin 2014 ky raport është rreth 8%, përsëri një shifër tepër e ulët. Megjithëse nga Sektori i Verifikimit në Terren, janë kryer kontrole me tematikë “verifikimin e ambienteve ku ushtrohet aktivitet”, vetëm për 5% të subjekteve, ka rezultuar një nivel i lartë i subjekteve të cilët operojnë në ambiente me qira dhe nuk derdhin detyrim tatim qiraje. *Trajtuar më hollësisht në faqet 36-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Nga Sektori i Verifikimit në Terren të organizohen kontrole tematike lidhur me verifikimin e ambienteve ku ushtrohet aktivitet si dhe masën e deklarimit dhe derdhjen e tatimit të qirasë.

Në vijimësi

B.4. Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurat e ndjekura për planifikimin për kontroll nga Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave u konstatua se niveli i mbulimit me kontroll paraqitet në nivele të ulta për subjektet problematikë. Kështu, nuk janë planifikuar dhe kontrolluar subjektet me gjendje më të lartë kreditore, me parregullsi në deklarim, me nivele të larta të detyrimeve të pashlyera. Kjo bie në kundërshtim me Udhëzimin e DPT-së nr. 4219, datë 27.02.2013 "Për zbatimin e procedurave të verifikimit të pasqyrave financiare për vitin fiskal 2012", pika 5 ku citohet "*Të dhënat nga shqyrtimi paraprak i pasqyrave financiare, sidomos për tatimpagues me humbje, normë të ulët rentabiliteti, si dhe tatimpagues të cilat gjykohen për verifikime të mëtejshme të deklarimeve në vend, të evidentohen dhe i dërgohen për ndjekje të mëtejshme Drejtorisë së Kontrollit Tatimor*". *Trajtuar më hollësisht në faqet 36-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave dhe Kontabilitetit, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, si dhe Drejtoria e Mbledhjes së Borxhit, të rrisin bashkëpunimin dhe të dalin me një propozim të përbashkët për subjektet tatimpagues që do ti nënshtrohen kontrollit tatimor.

Në vijimësi

B.5. Në aktkonstatimet e mbajtura nga inspektorët e kontrollit në terren, me objekt “Pajisjen e subjekteve me kasa fiskale dhe lëshimin e kuponit tatimor”, u konstatua se në përgjithësi nga ana e inspektorëve nuk është përshkruar në aktkonstatimi numri i fiskalizimit të kasës apo numri serial i kasës, si dhe nuk është bashkangjitur (fotokopje), kupon tatimor në datën e kryerjes së kontrollit.

Po kështu në rastet e konstatimit të subjekteve në fazën e regjistrimit në shumicën e rasteve nuk është bashkangjitur formulari i aplikimit në QKR. Nga ana e inspektorëve nuk është lënë gjurmë mbi kontrollin e kryer. *Trajtuar më hollësisht në faqet 122-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, në aktkonstatimet që do të mbahen nga inspektorët e kontrollit në terren, për rastet e specifikuara më lart, duhet të përkthyer:

- numri i fiskalizimit të kasës,

- bashkangjitur aktkonstatimit duhet të jetë kuponi tatimor në datën e kontrollit,

- fotokopje e formularit të aplikimit në QKR, me qëllim lënien e gjurmës për kontrollet e kryera nga ana e inspektorëve të kontrollit në terren.

Menjëherë

B.6. Në DRT Elbasan, është evidentuar mungesë bashkëpunimi midis drejtorive dhe sektorëve, si rrjedhojë e mungesës së Rregullores së Brendshme mbi funksionimin e saj, ku të jetë përcaktuar funksionimi sipas organigramës së miratuar, detyrat, përgjegjësitë sipas funksionit dhe pozicionit të punës, forma dhe mënyra e bashkëpunimit midis drejtorive dhe sektorëve, lëvizja e dokumentacionit etj. *Trajtuar më hollësisht në faqet 165-166 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Nga DRT Elbasan, në përshtatje me Rregulloren së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore nr. 8608, datë 04.10.2010, miratuar nga Ministri i Financave, pjesa II, “Drejtoritë Rajonale”, të hartojë dhe të miratojë në DPT, Rregulloren e Brendshme mbi funksionimin e saj.

Menjëherë

B.7. Nga auditimi ka rezultuar se DRT Elbasan nuk ka bashkëpunuar me DRT e tjera për subjektet që kanë shtrirë veprimtarinë e tyre në fushën e lojërave të fatit, me qëllim mbulimin e tyre më kontrolle në terren dhe evidentimin e aktivitetit, njoftimin e NJMLF-së, si dhe marrjen e masave në kohë për bllokimin e aktivitetit të paligjshëm të tyre dhe mos deklarimit të tij. *Trajtuar më hollësisht në faqet 80-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, DRT Elbasan me marrjen e njoftimeve nga NJMLF, për mbylljen e aktivitetit, apo NIPT-ve sekondare nga subjektet e regjistruara në DRT Elbasan, duhet të bashkëpunojë me DRT përkatëse, ku kanë shtrirë veprimtarinë këto subjekte, për ushtrimin e kontrolleve ndaj tyre.

Menjëherë

B.8. Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesit u konstatuan vonesa të mos heqjes nga sistemi informatik i subjekteve, të cilët kishin marrë statusin e “subjektit të çregjistruar”, si dhe vërtetimin nga DRT për QKR, që subjekti të çregjistrohej. Këto vonesa, të cilat kanë variuar deri në 1 vit, bien në kundërshtim me parashikimet e ligjit 9920, datë 19.05.2008, me ndryshime, neni 45 “Çregjistrimi i tatimpaguesit”, duke zvarritur procesin e çregjistrimit të tatimpaguesit nga sistemi tatimor. *Trajtuar më hollësisht në faqet 36-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Të monitorohet dhe të analizohet çdo tremujor reflektimi në sistemin informatik të tatimeve, situatat e vonesave, për subjektet të cilët kanë aplikuar për çregjistrim në QKR dhe kanë plotësuar kushtet për t’u çregjistruar, me qëllim që të reflektohet menjëherë dalja nga sistemi i këtyre tatimpaguesve.

Menjëherë

C. MASA SHPËRBLIM DËMI:

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandoj, Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, marrjen në shqyrtim të tyre, në lidhje me detyrimet tatimore të pa përllogaritura dhe të pa kontabilizuar, të cilat në total janë në shumën **142,160,527 lekë**, për praktikat e mëposhtme:

C.1. Për 38 raste (subjekte), të mos vendosjen e penaliteteve në shumën **107,401,347 lekë**, sipas aneksit nr. 3, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, pasi nga inspektorët e kontrollit operacional është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”. *Trajtuar në faqen 90-122 të RPA.*

Deri 31.12.2015

C.2. Për 95 raste (subjekte), të mos vendosjen e penaliteteve në shumën **28,760,000 lekë**, sipas aneksit nr. 4.1 dhe 4.2, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, pasi nga inspektorët e kontrollit në terren, është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”. *Trajtuar në faqen 123-140 të RPA.*

Deri 31.12.2015

C.3. Për 9 raste (subjekte), të mos vendosjen e penaliteteve në shumën **4,897,014 lekë**, sipas aneksit nr. 2, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, pasi nga inspektorët e kontrollit operacional është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”. *Trajtuar në faqet 69-78 të RPA.*

Deri 31.12.2015

C.4. Për 27 raste (subjekte) të mos vendosjes së penaliteteve në shumën **640,000 lekë**, sipas aneksit nr. 1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, pasi është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008, neni 126 "Mosdhënia e informacionit" ku citohet "Refuzimi për dhënien e informacionit të kërkuar nga administrata tatimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, dënohet me gjobë me 10 000-50 000 lekë për çdo shkelje". *Trajtuar në faqet 40-41 të RPA.*

Deri 31.12.2015

C.5. Për subjektin [REDAKTUAR] në shumën **264,438 lekë** dhe subjektin [REDAKTUAR] në shumën **100,688 lekë**, për mos vendosje të penaliteteve, në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”. *Trajtuar në faqen 85-86 të RPA.*

Deri 31.12.2015

C.6. Për subjektet [REDAKTUAR] në shumën **19,103 lekë**, subjektin [REDAKTUAR] në shumën **10,500 lekë** dhe subjektin [REDAKTUAR] në shumën **47,216 lekë**, për vendosje të penaliteteve, pasi nga ana e tyre, është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”. *Trajtuar në faqen 163-165 të RPA.*

Deri 31.12.2015

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandoj

Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Elbasan, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

Neni 58, germa (c) “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për 14 nëpunës civilë si më poshtë:

1. [REDAKTUAR], Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
2. [REDAKTUAR], Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
3. [REDAKTUAR], Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
4. [REDAKTUAR], Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
5. [REDAKTUAR], Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

-Për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” me ndryshime dhe udhëzimin nr. 24 datë 02.09.2008, neni 44 dhe 45.

-Për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008, nenit 126 “Mosdhënia e informacionit”, nuk kanë vendosur gjobë.

-Nuk kanë bërë rivlerësimin e vlerës së tatimit të qirasë për vitin 2013 dhe 2014, në bazë të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R. SH”, neni 6 “Detyrimi Tatimor”, neni 34 “Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jo tregtare”, neni 70 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi” si dhe neni 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit” dhe udhëzimin nr. 4219, datë 27.02.2013 “Për zbatimin e procedurave të verifikimit të pasqyrave financiare për vitin fiskal 2012”, pika 5. *Trajtuar në faqet 36-85 të RPA.*

6. [REDAKTUAR], Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
7. [REDAKTUAR], Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
8. [REDAKTUAR], Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
9. [REDAKTUAR], Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

-Për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, pasi në kontrollet e ushtruara ndaj subjekteve tatimpagues, vendosja e penaliteteve për shkeljet e konstatuara nuk ka qenë në përputhje me ata të parashikuara në Kreu XIV “Sanksionet”, nenet 11-130. *Trajtuar në faqet 89-122 të RPA.*

10. [REDAKTUAR], Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
11. [REDAKTUAR], Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
12. [REDAKTUAR], Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

-Për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, pasi nuk janë vendosur në përputhje me shkeljet e konstatuara, penalitetet që parashikohen në Kreu XIV “Sanksionet”, nenet 11-130. *Trajtuar në faqet 122-140 të RPA.*

13. [REDAKTUAR] Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.

-Nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor, nuk është bërë vlerësim i efektiv, për përcaktimin e subjekteve që duhet të kontrollohen. Kjo bie në kundërshtim me udhëzimin nr. 4219 datë 27.02.2013 “Për zbatimin e procedurave të verifikimit të pasqyrave financiare për vitin fiskal 2012”, pika 5 ku citohet “Të dhënat nga shqyrtimi paraprak i pasqyrave financiare, sidomos për tatimpagues me humbje, normë të ulët rentabiliteti, si dhe tatimpagues të cilat gjykohen, për verifikime të mëtejshme të deklarimeve në vend, të evidentohen dhe të dërgohen për ndjekje të mëtejshme Drejtorisë së Kontrollit Tatimor”. *Trajtuar në faqet 36-85 të RPA.*

14. [REDAKTUAR] Drejtor të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesit (i komanduar).
-Ka vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, pika 45 “Çregjistrimi tatimor”, pika 45.1 “Çregjistrimi i personave të tatueshëm që kryejnë veprimtari ekonomike e tregtare, pika 45.3 “Efektet tatimore të çregjistrimit” si dhe Rregulloren nr. 3, datë 11.10.2010, pika 1 “Kërkesat lidhur me konfirmimin e statusit të tatimpaguesit dhe individëve” dhe pika 2 “Përditësimi i të dhënave dhe regjistrave” dhe mos mbajtje të regjistrit të subjekteve të paregjistruar. *Trajtuar në faqet 25-36 të RPA.*

-Për punonjësit, të cilët janë atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për mangësi në zbatimin e detyrave funksionale, por në raste të veçanta, nuk rekomandohen masa disiplinore.

-Ndërsa, për 19 punonjës, shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” janë në nivelin e masës disiplinore neni 58, germa (c), “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, por që nuk janë rekomanduar, për arsye se kanë shkëputur marrëdhëniet me institucionin.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Shënim: Auditimi u krye përgjatë periudhës 10.03.2015 deri më 21.05.2015, nga audituesit Brunilda Zeneli, përgjegjëse grupi, Edvin Stefani, Vladimir Rizvani, Joniada Goçaj, anëtarë, u mbikëqyr nga Kryeauditues z. Albert Thoma, më tej u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

DRT Elbasan nuk ka kthyer ende përgjigje për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve pasi është brenda afatit ligjor për kthimin e përgjigjes.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT